

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/15/gjykata-e-larte-merr-vendimin-per-veliajn-kryebashkiaku-mbetet-ne-burg/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:14:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 09:06:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 09:05:00 UTC → 15 shtator 2026, 09:07:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e8316752a8af1a44361d10d91c7be902719bed388c52f97a3638fe3a7be53e7c
TEKSTI	7aeb07f3a5a3647bf8d5577bf2b767c789d55a9edf1b05b2415bdfc31f405071
PAMJA	6e4282b4a42485907555f7f3c0013243ff2e2fbfbcb858c05d90402ecafade47b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4b8c537f20a9403614f8f3c21b8472d432ed67ffc511630640d2cd860c802a47
E MËPARSHMJA	30a8aba82372a0594dd22bf41a49978deb0007ac0145e77878f7e9b7c65cd2ee
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4b8c537f20a9403614f8f3c21b8472d432ed67ffc511630640d2cd860c802a47>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

15/09/2026 11:06



Unanimisht, tre gjyqtarët e Lartë Sandër Simoni, Valbon Çekrezi dhe Gent Shala e refuzuan kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj, dhe shpallën qëndrimin për mbajtjen nën arrest me burg të Erion Veliaj.

E vënë në lëvizje nga Gjykata Kushtetuese që në maj i kërkoi Gjykatës së Lartë të shprehej se përse arresti në burg ishte e vetmja masë që duhet aplikuar ndaj kryebashkiakut dhe nëse ishte apo jo kjo masë proporcionale, gjyqtarët e Lartë vlerësuan se për përshtatshmërinë e masës ishte shprehur Gjykata e Apelit.

Ndaj Gjykata deklaroi në dispozitivin e shpërndarë medias se lë në fuqi vendimin e Apelit, datë 13 mars 2025, duke e çmuar se në këtë mënyrë çfarë nuk kishte thënë Gjykata e Lartë në rekurse e kishte shteruar Gjykata e Posaçme e Apelit.

Nga dhoma e këshillimit, ku u mor në shqyrtim dosja penale, Gjykata e Lartë vlerëson se masa është proporcionale dhe, me lënien në fuqi të vendimit të Apelit, argumentet lidhen sërish me rrezikshmërinë e veprave për të cilat Veliaj akuzohet, por edhe rrethana tjetër, ajo e bashkëpunimit me shumë se një herë dhe statusi i tij si funksionar publik. Të paktën këto kriterë janë renditur nga Apeli më tepër se një vit më parë.

Megjithatë, me lënien në fuqi të vendimit të Engert Pëllumbit, pritet që Gjykata e Lartë të shtojë argumentet e saj, mes tyre edhe si cënohet mandati i kryetarit të bashkisë me mbajtjen në burg.

I menjëhershëm ka qenë reagimi i Plarent Ndrecës, avokati i Veliajt, i cili e konsideroi vendimin si një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues, jo vetëm për sigurinë juridike, por edhe demokracinë.

Duke lënë në fuqi një vendimarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit. Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë.

Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë.

Hapi i radhës pritet të jetë sërish Gjykata Kushtetuese, ndërkohë që Veliaj nuk paraqitet në gjykimin e themelit, ku ndaj tij rëndojnë akuzat e korrupsionit, pastrim parash dhe fshehje pasurie, pasi kërkon që të nxirret nga kafazi e të ulet me avokatin përkrah.

Kryesore



"Do të vras po tregove"/ Rrëfimi tronditës i 34-vjeçares nga Roskoveci: Daja i deputetes Zegjine Çausi më rrëmbeu dhe përdhunoj, më premti punë se njihje shefat

14:57

Dosja "Revanshi"/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

09:32

Cënuan perimetritin e sigurisë në shkollë gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë

11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

09:50

Më të lexuarat

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsit dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

"Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat", analisti Sulo ngre alarmin: Ç'po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s'i ka shpëtuar arrestit

Vendimi 3 me 0 ndaj Veliajt/ Gjykata e Lartë

Aktualitet »



"Do të vras po tregove" / Rrëfimi tronditës i 34-vjeçares nga Roskoveci: Daja i deputetes Zegjine Çausi më rrëmbu dhe përdhunoj, më premti punë se njihte shefat

15/09 14:57



Ambasadori kroat Zlatko Kramarić nga Pogradeci: Protesta është e drejtë e qytetarëve, qeveria duhet të dëgjojë mesazhin

15/09 14:48



U kap me 297 doza heroine dhe kokaine, arrestohet në Durrës 21-vjeçari

15/09 13:44



"S'mund të pezullohet një i zgjedhur" / Gjyqi i Veliajt, juristi përplas me ish-prokurorin në 'Shqipëria Live': Ai izolohet që të mos ushtrojë detyrën, këta...

15/09 13:30



Shtyhet CENSI i Bujqësisë, ja kur do të nisë regjistrimi i sektorit bujqësor dhe blegtoral

15/09 13:14



Kishte kultivuar kanabis afër tokës së tij, arrestohet 41-vjeçari në Mallakastër, asgjësohen bimët narkotike

15/09 13:08

Kryesore »



Debate te Ligjet/ Manja: Do diskutoni për projektligjin e pagave, jo vendimin e Kushtetutes; Kreu i unionit të gjyqtarëve: Atë e dimë ne..

15/09 15:06



Skandali apo rregulli i hekurt? Pse Kosova po luan me "zjarrin" duke lënë jashtë dy më të mirët e Serie A

15/09 14:58



"Do të vras po tregove" / Rrëfimi tronditës i 34-vjeçares nga Roskoveci: Daja i deputetes Zegjine Çausi më rrëmbu dhe përdhunoj, më premti punë se njihte shefat

15/09 14:57



Pagat e magistratëve/ Kryetarja e KLP-së të Komisioni i Ligjeve kundër projektligjit të mazhorancës: Rritja minimale, nuk reflekton standardin e Kushtetutes

15/09 14:47



"I lidhni shallin sa herë ka mbledhje me partizanë", Korreshi përplas me Gogun për Sokol Sadushin, ministri: Po thua barsioleta, je i vetmi njeri që...

15/09 13:54



"S'mund të pezullohet një i zgjedhur" / Gjyqi i Veliajt, juristi përplas me ish-prokurorin në 'Shqipëria Live': Ai izolohet që të mos ushtrojë detyrën, këta...

15/09 13:30

Na ndiqni:

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews


Top Channel

Video »



Ja në fuqi Apelin, ja çfarë thoshte një vit më parë për paraburgimet

Dosja "Revanshi" / GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë



Top Channel/ Pagat e gjyqtarëve bashkojnë PS-PD. Manja pranon kërkesën e Bylykbashit




Top Channel/ Erion Veliaj mbetet në burg. Gjykata e Lartë rrezoi kërkesën për t'u hetuar i lirë



Top Channel/ Ilir Meta mbetet në burg. GJKKO nuk i zbut masën e ish-presidentit



Top News – Qeveria dyfishon bonusin për pensionistët. Ibrahimaj: Vendimi në fuqi nga 1 janari 2027



Top News – Zgjerohet tregtia me pakicë, volumi i shitjeve rritet edhe për karburantet



Top Channel/ Nesër trazira në Kosovë? Franca paralajmëron shtetasit: "Shmangni daljet në rrugë"!

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.